**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**
**JANAR - DHJETOR 2024**

| Nr. Ren dor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit tëkërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 22.12.2023 | - Cfare veprimesh ka ndermarre Ministria e Bujqesise pas nderprerjes se perkohshme te fondeve IPARD nga Komisioni Evropian? Cilat jane masat e marra per te adresuar çeshtjen e akuzave te korrupsionit?<br>- Si do te ndikoje nderprerja e fondeve ne zbatimin e politikave te zhvillimit rural ne Shqiperi?<br>- Cilat jane planet e Ministrise se Bujqesise per te permbushur kerkesat e Komisionit Evropian dhe rikuperuar ndihmat financiare? | 18.1.2024 | Programi ipard 2 ka perfunduar ne dhjetor 2023 dhe pagesat nga autoriteti vijojnë dhe per nje pjese kontratash qe jane lidhur me vone kemi marre aprovimin per nje shtyrje me nje vit te disbursimit. Likujdimi i fondeve eshte on hold deri ne marrjen e masave sipas planit te masave.<br>Puna vazhdon në bashkëpunim të plotë me strukturat e BE-së për plotësimin e kërkesave dhe kushteve që kërkohen për t'u përmbushur.<br>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëpërmjet strukturave menaxhuese dhe zbatuese të Programit IPARD, ka përgatitur një raport të detajuar me një plan masash për adresimin e problematikave dhe rritjen e kapaciteteve institucionale per sigurimin e metejshem te zbatimit te kushteve dhe kritereve të Marrëveshjes Sektoriale dhe Marrëveshjes Financiare. | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 2. | 16.1.2024 | 1. Sa eshte numri i akteve ligjore qe keni konsultuar me organizatat jofitimprurese gjate vitit 2023? | 30.1.2024 | 1. Numri i akteve ligjore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të cilat janë konsultuar me organizatat | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2. Kush kanë qenë format e konsultimit që keni përdorur?<br>3. Sa është numri i OJFve që kanë marrë pjesë në këto konsultime?<br>4. A ka institucioni juaj Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik ? Nëse po ju lutem citoni kontaktin.<br>5. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin.<br>6. A ka organe keshillimore qe funksionojne prane institucionit tuaj? Nese po, ju lutem citojini ato.<br>7. A janë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nese PO, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë të përfshirë në to?<br>8. Gjate 2023, a ka patur insittucioni juaj grupe te perbashketa pune me pjesemarjen e OJFve?<br>9. A eshte trajnuar stafi I institucionit tuaj mbi veprimtarine dhe funksionimin e OJFve? Nese po, sa punonjes jane trajnuar dhe nga kush?<br>10. A ofron institucioni Juaj licenca per sherbime te caktuara qe ofrohen nga OJF? Nëse po, specifikoni llojin e sherbimit? Sa OJF janë licensuar sipas llojit te sherbimit? | | jofimprurëse është 4 (katër) akte.<br>• a. Takimet fizike me grupet e interesit.<br>b. Konsultimi elektronik përmes Regjistrit Elektronik (RENJK)<br>c. Komunikime nëpërmjet postës elektronike<br>3. Numri I OJF-ve që kanë marrë pjesë është 15.<br>4. Po ka, kontakti është Kjara.vogli@bujqësia.gov.al<br>5. Jo.<br>6 dhe 7. Per pyetjet nr. 6 dhe 7: Në Komisionin Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën, i cili jep mendime dhe sugjerime për çështje të përgjithshme dhe të analizës së zinxhirit të peshkimit, për hyrjen në burime dhe aktivitetin e peshkimit, për politikat strukturore, për organizimin e tregut dhe probleme të akuakulturës janë të përfshirë edhe përfaqësues të OJF-ve si: menaxheri i OMP Shkodër.<br>8. Jo, nuk ka patur.<br>9. Jo, nuk ka patur.<br><br>10. Po, Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) të cilat kanë statusin e një OJF-je. Në ujërat e brendshme dhe të shpallura si zona bashkëmenaxhimi peshkimi janë pajisur me kontratë, si më poshtë:<br>Për Zonën Bashkëmenaxhuese Laguna | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nartë dhe Orikum, është pajisur me Kontratën Nr. 6204 prot., datë 09.09.2013 "Për ushtrimin e veprimtarisë peshkimit peshkimit në ujrat e brendshme për zona bashkëmenaxhuese", Organizata e Menaxhimit të Peshkimit Nartë.<br>Për Zonën Bashkëmenaxhuese Liqeni Shkodër, është pajisur me Kontratën Nr. 6213 prot., datë 09.09.2013 "Për ushtrimin e veprimtarisë peshkimit peshkimit në ujrat e brendshme për zona bashkëmenaxhuese", Organizata e Menaxhimit të Peshkimit Liqeni Shkodrës.<br>Për Zonën Bashkëmenaxhuese Laguna Karavastasë, është pajisur me Kontratën Nr. 3777 prot., datë 25.05.2014 "Për ushtrimin e veprimtarisë peshkimit peshkimit në Zona Bashkëmenaxhuese të Karavstasë", Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit "Laguna Divjakë".<br>Për Zonën Bashkëmenaxhuese në Liqenin e Ohrit, është pajisur Kontratën Nr. 6043 prot., datë 02.08.2016 "Për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit" Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit Liqeni Ohrit.<br>Për Zonën Bashkëmenaxhuese në Liqenet e Prespës (Prespë e Madhe & Prespë e Vogël), është pajisur Kontratën Nr. 783/1 prot., datë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 24.01.2018 "Për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit/akuakulturës", Organizata e Menaxhimit të Peshkimit "Prespë".<br>Për Zonën Bashkëmenaxhuese "Liqeni Ulëz dhe Shkopet", është pajisur me Kontratën Nr. 10016 prot., datë 29.10.2018 "Për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit", Organizata e Menaxhimit të Peshkimit "Liqeni Ulëz".<br>Këto organizata menaxhimi peshkimi marrin pjesë në bashkëmenaxhimin e burimeve të peshkimit sipas zonave të caktuara në kontratë.<br>Lidhur me OMP-të në ujërat detare, për zonën e Portit të Peshkimit Durrës është pajisur me Akt Marrëveshje Nr. 35/1prot., datë 26.01.2019 Organizata e Menaxhimit të Peshkimit Durrës. | | |
| 3. | 21.2.2024 | Kërkoj vendosjen në dispozicion të relacioneve përfundimtare të VKM-ve të mëposhtme, të miratuara me<br>propozim të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:<br>VKM nr. 763, date 20.12.2023 "Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Kuvajtit, për bashkëpunimin në fushën e Bujqësisë"<br>VKM nr. 825, date 28.12.2023 "Për miratimin e tarifave të shërbimeve dhe të analizave, që kryhen nga laboratori i referencës dhe laboratorët e miratuar"<br>VKM nr. 826, date 28,12,2023 "Për | 7.3.2024 | MoU.pdf<br>RELACION.pdf<br>shtesa vkms.pdf<br>Signed_Relacionper zbardhjeDSHPA.pdf | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”<br>VKM nr. 833, date 28.12.2023“Për një shtesë në vendimin nr. 125, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2023"” | | | | |
| 4. | 4.3.2024 | 1-Sa sipërfaqe toke mbillet me duhan në territorin e Shqipërisë gjatë një sezoni?<br>2-Sa prodhim del nga kjo mbjellje duhani?<br>3-Sa prodhim qendron për konsum të brendshëm dhe sa për eksport?<br>4-Sa ton duhan i kultivuar në territorin shqiptar tregtohet gjatë një viti kalendarik në mënyrë të<br>paligjshme në vendin tonë?<br>5-Nga analiza e grupit të punës, në raportin e vlerësimit për projektligjin, me institucionin tuaj si ministri udhëheqëse, u konstatua se 25-30% e konsumit të duhanit është informal, nuk paguan taksa, çka përkthehet në 30-50 mln euro dëm buxhetit të shtetit, si është menduar të shpenzohet ky buxhet<br>nëse arrihet të mblidhet nga ky formalizim tregu?<br>6-Pse Shqipëria nuk e përqafoi Konventën e Kontrollit të Duhanit në nivel botëror, zhvilluar më datë 5-10 shkurt në Panama, | 8.3.2024 | Deleguar AKDC. Pergjiga i eshte kthyer me shkrese nga AKDC. | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe Traktatin për Tregtinë e Paligjshme zhvilluar më datë 10-12 shkurt, me 83 shtete anëtare dhe vëzhguese? | | | | |
| 5. | 12.3.2024 | 1-Të më informoni se cila/t është/janë, arsyeja/arsyet, që Projekt/ligji "Për Kultivimin, Grumbullimin, Përpunimin, Prodhimin dhe Tregtimin e Duhanit dhe të Produkteve të tij", i depozituar në Kuvend më<br>datë 09.12.2021, ka mbetur pezull-është kthyer? – duke mos kaluar për shqyrtim në komisione për dhënie mendimi apo komisione përgjegjëse, e më pas në seancë?<br>2-Të më mundësoni një intervistë zyrtare me drejtorin ose një nëpunës kompetent nga Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve, pranë M.B.ZH.R, lidhur me:<br>-nismën e këtij projekt/ligji;<br>-vonesat në shqyrtim e kalim në Kuvend (sa ka ndikuar?);<br>-nevojën ose jo për përafrimin me ligjet e BE;<br>-nevojën ose jo për rishikim të projekt/ligjit. | 2.4.2024 | Pergjigje1.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 6. | 18.3.2024 | A ka të miratuara model certificate veterinare për kafshë të gjalla të llojit gjedh dhe të imta për therje për import me origjinë nga Ukraina<br>Dhe per kafshë të gjalla të llojit të imta (qingja) për therje për import me origjinë nga Maqedonia e Veriut. Nëse janë të miratuara nje kopje të model certifikatave | 8.4.2024 | Ne pergjigje te kerkeses suaj per informacion bashkelidhur do te gjeni modelet e miratuara te certifikatave. Në lidhje me importin nga shteti i Ukrainës, duhet të përcaktohet territori, vendi ose zona nga do të importohen kafshët në mënyrë që Autoriteti Kompetent të kontrollojë situatën | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | të tilla. Nëse nuk janë të miratuara na informoni mbi procedurën që duhet ndjekur dhe sa zgjat ky process. | | epidemiologjike. Për aprovimin e certifikatës kohëzgjatja mund të shkojë deri në dy javë kjo edhe në varësi të përgjigjes nga pala Ukrainase.<br>Urdher nr.174 dt.23.4.2021.pdf Urdher nr.91 dt.17.2.2021.pdf | | |
| 7. | 27.3.2024 | A eshte kalimi/zevendesimi i kompetencave nga ministri ten je vartes? Nese po na vini ne dispozicion urdhrin me ane te se cilit eshte miratuar ky kalim. | 5.4.2024 | Pergjigja adresohet ne linkun https://qbz.gov.al/eli/urdher/2024/02/09/80/10081c92-bc06-4775-b536-66d20f71a350 | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 8. | 29.3.2024 | Kerkese per listat konkrete me afatet e ruajtjes se dokumentave te Ministrise se Bujqesise per periudhat vjetore 2010, 2017 | 12.4.2024 | Per dokumentacionin e viteve 2010, 2017 nuk rezulton te kete "Liste konkrete me afatet e ruajtjes se dokumenteve" | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 9. | 12.4.2024 | Kërkoj të informohem me informacionin si më poshtë:<br>1- Për vitin 2010 dhe 2017 a është ngritur komisioni i ekspertizës në përputhje me nenin 5 të vendimit nr. 4, datë 19.6.2017për miratimin e “rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”?<br>2- Si institucion fondkrijues mbi çbazë/veprimtari ligjore jeni mbështetur për të bërë klasifikimin e dokumentave për arkivimin e dokumentave si të përkohshëm/përhershëm për periudhat vjetore 2010 dhe 2017? | 2.5.2024 | Në lidhje me pikën e parë të kërkesës ju informojmë se nga kërkimi në arkivën e MBZHR-së në dokumentacionin e vitit 2017 u gjet urdhri nr. 209, datë 19.5.2017 "Për zëvëndësimin e kryetarit të komisionit të ekspertizës për përcaktimin e afateve dhe vlerës së ruajtjes së dokumentacionit pranë zyrave të arkivit të MBZHRAU" pasi Urdhri "Për krijimin e komisionit të ekspertizës për përcaktimin e afateve dhe vlerës së ruajtjes së dokumentacionit pranë zyrave të arkivit në MBZHRAU" ka dalë në vitin 2016 me urdhrin nr. 23, datë 12.1.2016. Komisioni i ngritur me urdhrin e vitit 2016 ka miratuar listën konkrete me | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | afatet dhe vlerën e ruajtjes së dokumentacionit pranë zyrave të arkivit në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, viti 1991, me shkresën nr 203/1 prot., datë 30.05.2016. Nga kërkimi në dokumentacionin e vitit 2010 nuk u gjet urdhër për komision ekspertize.<br>Në lidhje me pikën e dytë të kërkesës ju informojmë se dokumentacioni i vitit 2010 dhe 2017 nuk është klasifikuar në dokumente të përkohshme/përhershme.<br>Dokumentacionit të këtyre viteve nuk i është bërë përpunimi tekniko-shkencor pasi në arkiv ka dokumente të viteve të mëparshme të prapambetura, të papërpunuara dhe është duke u bërë përpunimi i dokumentacionit të viteve më të hershme. | | |
| 10. | 18.4.2024 | - A keni nje pergjigje nga Komisioni Evropian lidhur me raportin e dorezuar vitin e kaluar per programin IPARD III? Nese po, cilat jane pikat kryesore qe adreson raporti? - Referuar nje deklarate publike te zevendesministrit te bujqesise, IPARD III rikthehet ne vitin 2025? Ku bazohet kjo deklarate? A i qendron Ministria e Bujqesise ketij afati? - Nese jo, kur pritet te celen fondet e IPARD III per Shqiperine? | 2.5.2024 | Në zbatim të nenit 61 (1), të Marrëveshjes Sektoriale për programin IPARD III, miratuar me ligjin nr. 97/2022, deri më 30 qershor të çdo viti pas një viti të plotë kalendarik të zbatimit të programit IPARD III, Autoriteti Menaxhues i IPARD-it, pas konsultimit me Agjencinë IPARD harton raporte vjetore mbi zbatimin e programit IPARD III gjatë vitit kalendarik pararendës, sipas nenit 62 (2) të MFKP-së. Raporti i parë i dorëzuar mbulon vitet kalendarike nga viti 2021 e në vazhdim. Në këto kushte, lidhur me sa kërkohet ju bëjmë me dije se deri më tani nuk është | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dorëzuar një raport i tillë, pasi programi IPARD III, nuk ka filluar ende zbatimin e tij. Dhe për sa i përket rikthimit apo çeljes së fondeve të IPARD III, programi IPARD III përpara fillimit të zbatimit të tij, duhet të plotësojë kushtet sipas nenit 13 të Marrëveshjes Financiare në Kuadër të Partneritetit, miratuar me ligjin 65/2022 | | |
| 11. | 18.4.2024 | Kërkoj të pajisem me informacionin e saktë si më poshtë:<br>-datën dhe nr e protokollit të Programit "Për Menaxhimin e Qëndrueshem te Tokës Bujqësore", i realizuar ne perputhje me Udhezimin Nr. 7, date 10.5.2010 "Per krijimin e informacionit mbi token Bujqësore" | 2.5.2024 | Për vitin 2010 në arkivën e MBZHR nuk janë gjetur të dhëna lidhur me datën dhe numrin e protokollit të Programit "Për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore" i realizuar në përputhje me Udhëzimin nr.7, datë 10.05.2010 "Për krijimin e informacionit mbi tokën bujqësore". Shkresa nr. 298/3, datë 18.1.2010 rezulton të jetë ridërgimi i buxhetit për vitin 2010 nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të asaj kohe drejt institucioneve vartëse dhe aparatit të ministrisë. | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 12. | 22.4.2024 | Venien ne dispozicion te Urdhrit te leshuar nga Ministria e Bujqesise (asokohe Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit), perkatesisht Urdhri nr. 257, date 11.06.2008 Per miratimin e rregullores "Per produktet e kakaos dhe çokollates". | 2.5.2024 | urdher 257.pdf | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 13. | 22.4.2024 | kërkesa për informacion duke kërkuar relacionet përfundimtare të:<br>- Vendimit nr. 130, datë 6.3.24 "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve | 2.5.2024 | Signed_31Relacioni permiratim1.pdf<br>2Signed_3Relacion permiratim.pdf | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë e Zhvillimin Rural, për vitin 2024"<br>- Vendimit nr.188, datë 27.3.24 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për prodhimin, tregtimin, ruajtjen, ambalazhimin, etiketimin dhe përdorimin e produkteve plehëruese"<br>- Vendimit nr. 226, datë 9.4.24 "Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes" | | Signed_2Relacionip ermiratim2931.pdf | | |
| 14. | 25.4.2024 | Kërkohen të dhënat e mëposhtme nga institucioni juaj:<br>- Plani vjetor i konsultimit publik për vitin 2022<br>- Lista/Databaza institucionale e grupeve të interesit/lista institucionale e ekspertëve<br>- Numri total i aktorëve jo qeveritarë që kanë marrë pjesë në konsultimet e institucionit për vitin 2022 dhe 2023; numri i pjesëmarrësve kontribues për këtë vit.<br>- Numri total i aktorëve jo qeveritarë që kanë marrë pjesë në hartimin e akteve të institucionit për vitin 2022 dhe 2023; numri i pjesëmarrësve kontribues për këtë vit.<br>- Numri total i komenteve të marra nga | 10.5.2024 | Kerkese per informacion MBZHR | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | institucioni për vitin 2022 dhe 2023, nr. i komenteve të pranuara plotësisht, nr. i komenteve të pranuara pjesërisht, numri i komenteve të refuzuara dhe nr. i komenteve të patrajtuara/pa përgjigje.<br>- Matrica e përjashtimit nga konsultimi publik për aktet për të cilat është përgjegjës institucioni juaj për vitin 2022 dhe 2023.<br>- Studime, sondazhe, analiza të tjera të ndërmarra nga institucioni juaj në lidhje me vlerësimin e efektivitetit të metodave të konsultimit publik dhe pjesëmarrjes së aktorëve jo qeveritarë/institucionalë, gjatë vitit 2022 dhe 2023. Nëse ka të tilla, vihen në dispozicion rezultatet/gjetjet e analizës.<br>- Raporte monitorimi dhe vlerësimit të proceseve të konsultimeve publike të mbajtura nga vetë institucioni gjatë vitit 2022 dhe 2023. Nësë ka të tilla, vihet në dispozicion dokumenti përkatës me gjetjet dhe rekomandimet.<br>Projektligji "Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqesore"<br>- Plani individual i konsultimit publik<br>- Skeda e analizës së metodave të konsultimit për këtë akt<br>- Matrica e palëve të interesit për këtë akt<br>- Informacion për fazën e konsultimit paraprak të projektligjit; lista e aktorëve joqeveritarë që kanë marrë pjesë në hartim, e disagreguar sipas sektorëve/organizatave që ata përfaqësojnë; numri total i tyre. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Projektvendim “Për politikën kombëtare shqiptare për sigurinë agro-ushqimore"<br>- Plani individual i konsultimit publik;<br>- Skeda e analizës së metodave të konsultimit për këtë akt<br>- Matrica e palëve të interesit për këtë akt<br>- Institucioni propozues i aktit; lista e aktorëve joqeveritarë që kanë marrë pjesë në hartim, e disagreguar sipas sektorëve/organizatave që ata përfaqësojnë; numri total i tyre.<br>- Ndikimi i konsultimit publik tek Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA)<br>Vendim nr. 578, datë 02.12.2022 “Për planin e veprimit për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve në Shqipëri për vitet 2022-2032"<br>- Raporti individual i konsultimit publik<br>- Plani individual i konsultimit publik<br>- Skeda e analizës së metodave të konsultimit për këtë akt<br>- Lista e pjesëmarrësve jo qeveritarë në procesin e konsultimit, e disagreguar sipas sektorëve/organzatave që ata përfaqësojnë, numri total i tyre.<br>- Matrica e palëve të interesit për këtë akt<br>- Informacion për fazën e hartimit të aktit; konsultim paraprak të tij; përbërja e grupit të punës për hartimin e aktit dhe institucioni propozues; lista e aktorëve | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | joqeveritarë që kanë marrë pjesë në hartim, e disagreguar sipas sektorëve/organizatave që ata përfaqësojnë; numri total i tyre.<br>- Ndikimi i konsultimit publik tek Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA)<br>Ligji nr. 20/2023 "Për Bletarinë"<br><br>- Plani individual i konsultimit publik<br>- Skeda e analizës së metodave të konsultimit për këtë akt<br>- Matrica e palëve të interesit për këtë akt<br>- Informacion për fazën e hartimit të aktit dhe konsultimit paraprak të tij;<br>- Ndikimi i konsultimit publik tek Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA)<br>Vendim nr. 460, datë 29.06.2022 "Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027"<br>- Plani individual i konsultimit publik;<br>- Skeda e analizës së metodave të konsultimit për këtë akt<br>- Lista e pjesëmarrësve jo qeveritarë në procesin e konsultimit, e disagreguar sipas sektorëve/organzatave që ata përfaqësojnë, numri total i tyre.<br>- Matrica e palëve të interesit për këtë akt<br>- Ndikimi i konsultimit publik tek Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 15. | 5.6.2024 | - Ne cfare faze eshte aktualisht cikli i trajnimeve te dedikuara per blegtoret?<br>- Nese trajnimet kane nisur, ku po kryhen?<br>- Sa eshte kohezgjatja e trajnimit te blegtoreve?<br>- Sa pjesemarres ka pasur ne ciklin e pare?<br>- A do te vijoje me tej ky cikel trajnimesh?<br>- Ka pasur interes nga blegtoret? | 14.6.2024 | Ne pergjigje te kerkeses suaj ju bejme me dije se MBZHR nuk disponon informacion sepse "Akademia e Barinjve" eshte ne kompetence te Universitetit Bujqesor te Tiranes. | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 16. | 24.6.2024 | - Si po ndikon nderprerja e fondeve ne zbatimin e politikave te zhvillimit rural ne Shqiperi?<br>- Cilat jane planet e Ministrise se Bujqesise per te permbushur kerkesat e Komisionit Evropian dhe rikuperuar ndihmat financiare?<br>- A keni nje pergjigje nga Komisioni Evropian lidhur me raportin e dorezuar vitin e kaluar per programin IPARD III? Nese po, cilat jane pikat kryesore qe adreson raporti? | 25.6.2024 | Ne pergjigje te kerkeses suaj per informacion bej me dije se per pyetjet nr 1 dhe 2 ju kemi kthyer pergjigje me emailin e dates 30.1.2024, ndersa per pyetjen nr. 3 ju keni marre pergjigje me emailin e dates 2.5.2024. | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 17. | 28.6.2024 | 1. Ju lutem na vendosni ne disapozicion, numrin e rasteve ne te cilat Ministria e Bujqesise ka perdorur te dhenat (imazhet, video etj) e prodhuara nga satelitet Albania 1 dhe Albania 2.<br>2. Sa punonjes jane te trajnuar ne strukturat e Ministrise se Bujqesise per te lexuar te dhenat e perftuara nga satelitet Albania 1 dhe Albania 2?<br>3. Kur dhe sa kane zgjatur keto trajnime te personelit nese jane realizuar dhe cila ka qene kostoja e tyre?<br>4. Ju lutem na vendosni ne dispozicion se ne sa raste jane perdorur dhe per cfare jane | 12.7.2024 | Kthim pergjigje.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | perdorur te dhenat e perftuara nga satelitet Albania 1 dhe Albania 2 nga strukturat ne varesi te Ministrise se Bujqesise.<br>5. Ju lutem na vendosni ne dispozicion se cfare te dhenash perfton dhe perdor Ministria e Bujqesise ne te gjitha strukturat e saj nga Satelitet Albania 1 dhe Albania 2? | | | | |
| 18. | 27.6.2024 | Marrëveshjet financiare me donatorë të huaj ku MBZHR është përfituese fondesh në formë granti, marrëveshjet në formë huaje zhvillimore dhe listën e projekteve me financim të huaj ku MBZHR është partenere ose lider. Informacioni kërkohet për 5 vitet e fundit. | 17.7.2024 | Lista e projekteve ne Word.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 19. | 15.7.2024 | Interesohem per proceduren e pajisjes se nje shtetasi me Nipt si fermer. Me informuan se aplikohet ne ealbania, por me pare duhet marre nje vertetim ne Drejtorine Rajonale. Nga kerkimet ne webin e MB me dolen Agjensite Rajonale, respektivisht agjensia e Tiranes.<br><br>Sa me siper, mund t'me thoni ju lutem nese jeni ju institucioni kompetent, adresa dhe oraret e terheqjes se vertetimeve? Ne te kundert, ndonje informacion tjeter, ju lutem. | | Dokumentat që i kërkohen qytetarit për Vërtetim për Nipt/Kartë fermeri.<br><br>1) Kërkesa e fermerit<br>2) Paisja me Kartë fermeri (Hapje e KoditAL të Fermës nese është fermer për herë të parë)<br>3) Fotokopje e ID<br><br>4) Cërtifikata e pronësisë /AMTP apo Kontrata e Qerasë .<br><br>5) Deklarata e konfirmimit nga specialistiti i ekstensionit që mbulon Nj. Administrative.<br>6)Në rastet e bashkëpronësisë Çertifikatë Familjare e muajit korrik 1991, nga Gjendja Civile përkatëse, në momentin e marjes së AMTP /Vertetim nga NJAD.<br>**Aplikimi për NIPT kryhet online** | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Orari:<br>E hëne -E Enjte 08:00-16:30<br>E premte 08:00-14:00<br>**Adresat:**<br>**Areb Tiranë**: Rruga Siri Kodra, Nr.89<br>**Areb Korçë**: Rruga e Voskopojës, Korçë | | |
| 20. | 19.7.2024 | -Numrin e fermave bujqësore sipas moshës dhe gjinisë së drejtuesit të fermës për periudhën 2020-2023<br>- Numrin e përfituesve nga skema kombëtare sipas grupmoshave dhe gjinisë për periudhën 2018-2023<br>- Numrin e përfituesve nga IPARD sipas grupmoshës dhe gjinisë | 26.7.2024 | Ne pergjigje te kerkeses suaj per informacion per pyetjen e pare ju bejme me dije se informacioni mbi fermat bujqësore sipas moshës dhe gjinisë së drejtuesit, perben indikatorë makro që prodhohen nga CENSI i bujqësisë nga INSTAT, si institucioni i vetëm zyrtar për prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare. Të dhënat nga censi i fundit janë të aksesueshme në faqen e INSTAT sipas linkut në vijim:<br><br>https://www.instat.gov.al/al/temat/censet/censusi-i-bujq%C3%ABsis%C3%AB/#tab2<br><br>Per pyetjet dy dhe tre do te merrni informacion nga AZHBR si institucion pergjegjes, ne Cc te ketij emiali. | Përgjigja i është dhënë e plotë.<br>Pyetjet 2 dhe 3 u jane deleguar AZHBR. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 21. | 22.7.2024 | Lidhur me aktivitetin e mundshëm të akuakulturës në Bazenin Ujor të Vjosës, ju lutem kërkoj, si më poshtë vijon,<br>1. Sa është numri "instalimeve tokësore" (vaska, impiante të prodhimit të peshkut etj, përgjatë gjithë gjatësinë së Lumit Vjosa dhe në degët e saj (Langaricë, Shushicë, Bënçë, Drinos, Kardhiq, Zagori)?<br>2. Sa më sipër, sa leje të reja janë dhënë, prej 1 janarit 2023 e deri në 30 qershor 2024?<br>3. Lista e plotë e subjekteve (emrat e tyre tregtarë, ose niptet) që gëzojnë të drejtën për të ushtruar aktivitetin e akuakulturës (fizikë dhe juridikë) dhe ku ndodhen (Vjosa dhe degët e saj), saktësisht, vendndodhjet në të cilat këto subjekte ushtrojnë këtë veprimtari?<br>4. Për secilin nga subjektet në fjalë: a) çfarë lloj peshku kultivohet; b) sa është kapaciteti i përgjithshëm për secilin subjekt; c) çfarë mënyre prodhimi (metode apo teknologji) aplikohet?; d) ç'njësie administrative i përket subjekti në fjalë?<br>5. A keni caktuar ZPA në Basenin e Vjosës? Nëse po, ku konkretisht? | 31.7.2024 | pergjigjaA.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 22. | 26.7.2024 | Jam e interesuar për udhëzimin ose metodologjinë e konvertimit të numrit të kafshëve në njësi gjedhi. | 8.8.2024 | pergjigje.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 23. | 30.7.2024 | -A ka parashikuar ministria e bujqesise, fonde per rimbursimin ne raste te fatkeqesive natyrore?<br>Cila eshte rruga qe duhet te ndjeke një fermer ne rast demesh nga fatkeqesite natyrore?<br>Kur eshte shpeshtuar rastet e fenomeneve ekstreme si pasoje e ndryshimeve klimatike, a ka nje strategji ministria e bujqesise per | 14.8.2024 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) nuk ka bazë ligjore mbështetëse dhe për rrjedhojë mjete financiare për mbulimin e dëmeve në raste fatkeqësish natyrore.<br><br>E drejta e kompensimit është parashikuar në nenin 41, të Ligjit Nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", si dhe në kriteret | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | krijimin e nje fondi te vecante kompensimesh? | | specifike në mbështetje të këtij neni, të përcaktuara me VKM-në Nr. 329, datë 16.5.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.<br><br>MBZHR në Strategjinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027, për të përballuar sfidën e efekteteve të ndryshimit të klimës me pasoja mbi prodhimin bujqësor, të cilat afektojnë fermerët dhe aktorët ekonomikë në zonat rurale, si dhe në sektorin e peshkimit, ka parashikuar të ndërmarrë reforma institucionale dhe strukturore, që tashmë kanë filluar dhe do të fuqizohen më tej, nëpërmjet masave të planifikuara në këtë strategji por nuk është parashikuar një fond i veçantë kompesimesh për fenomenet ekstreme që vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike.<br><br>Gjithashtu, ka filluar zbatimi i porjektit "Qendrueshmeria ndaj klimes dhe zhvillimit te bujqesise" sipas link https://bujqesia.gov.al/projekti-qendrueshmeria-ndaj-klimes-dhe-zhvillimit-ne-bujqesi/ | | |
| 24. | 6.8.2024 | Lidhur me Kanalin Ujitës Vjosë-Levan-Fier, kërkoj si vijon,<br><br>1. Ku është pozicionuar burimi i ujit (vepra e marrjes; gjithashtu disa të dhëna teknike të saj: lartësia, gjatësia etj.); sa është sasia vjetore e ujit që merret; mënyra sesi merret (rrjedhje e lirë, pompim etj.); sip. që ujitet; bashkitë që mbulon kjo vepër? | 19.8.2024 | informacion DUK FIER.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2. Meqë Vjosa, së bashku me degët e saj shtrihet përgjatë 11 bashkive, a mund të kem një vlerësim të përgjithshëm mbi numrin e digave, apo të strukturave devijuese, pompat e mundshme, të cilat shërbejnë për ujitjen e tokave bujqësore që janë vendosur në Luginën e Vjosës; sasinë e përgjithshme të ujit që merret, si dhe sip. e përgjithshme bujqësore që mbulon vaditja? | | | | |
| 25. | 16.9.2024 | Strategjitë e parashikuara për kontrollin dhe menaxhimin e brucelozës te të imtat(dele – dhi).<br>Strategjitë dhe planet për gjurmimin e tuberkulozit (TBC) te gjedhi.<br>Statistikat dhe numrin e saktë të krerëve të gjedhit të therur gjatë vitit për shkak të diagnozës së brucelozës. | 10.10.2024 | pergjigje.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 26. | 19.9.2024 | 1. Referuar Planit të Kontrolllit për Brucelozën në të imta këtë vit nga informacionet e marra nga T.C. në rrugë zyrtare duhet vaksinuar e gjithë tufa e gjëse së gjallë. A është vënë kjo vaksinë në dispozicion dhe sa tufa janë vaksinuar?<br>2. Kur janë realizuar procedurat e tenderimit për vaksinën e brucelozës dhe a janë siguruar këto dy vaksina?<br>3. Po matrikullimi i kafshëve remonti nga ana juaj është realiziuar? Sa është numri i tyre dhe kur kanë qenë numrat e fundit që keni shpërndarë? | 10.10.2024 | 1. Programi i kontrollit të Brucelozës në të imta për vitin 2024, parashikon vaksinimin total të popullatës në të imta. Sigurimi i vaksinës bëhet në përputhje me procedurat e prokurimit publik si dhe ligjit të shërbimit veterinar Nr.10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili parashikon që produktet mjekësore veterinare në Shqipëri duke përfshirë edhe vaksinat duhet të jenë të rregjistruara në një nga vendet e Bashkimit Evropian. Procesi i tenderimit dhe rregjistrimi i vaksinës ka përfunduar. Eshte siguruar vaksina per fillimin e vaksinimit te kafsheve. Situata epizootike bazuar ne survejanca pasive te kryer është nën kontroll. | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 2. Procedurat e tenderimit kanë përfunduar, gjithashtu jane siguruar dozet per fillimin e vaksinimit.<br><br>3. Matrikullimi i kafshëve të remontit për periudhën Janar- Shtator për vitin 2024 për speciet janë si më poshtë vijon :<br>Të imta të matrikulluara janë 220,181 krerë;Gjedh të matrikulluara janë 71,082 krerë;Derra të matrikulluara janë 1,686 krerë;Sasia e matrikujve të shpërndarë për vitin 2024, është në total për speciet e ruminantëve të vegjël dhe derra 278080 (për remont) për gjedhin sasia e matrikujve për remont dhe therje ka matrikuj gjëndje dhe ska nevojë për blerje. | | |
| 27. | 24.9.2024 | Kërkohet informacion lidhur me bonitetin e një ngastre/toke bujqësore në bashkinë Roskovec ku do të ndërtohet termocentrali me gaz, si dhe nëse ka patur kërkesë nga ana e Këshillit Bashkiak për ndryshimin e statusit të këtaj ngastr/toke bujqësore | 10.10.2024 | 1. Lidhur me kërkesën për kategorinë e Bonitetit të Tokës Bujqësore/ngastrës, ku do të ndërtohet termocentrali me gaz në bashkinë Roskovec, sqarojmë se kërkesa duhet t'i drejtohet Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier, kjo referuar germës c) pika 4, nenit 12, kreu III, i Ligjit Nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës",i ndryshuar ku citohet se:"4.DAMT-ja kryen shërbime dhe jep informacione në bazë të dokumentacionit që disponon, sipas pikës 1 të këtij neni, për institucione shtetërore, si dhe për persona fizikë dhe juridikë për:c) kategorinë e tokës bujqësore, sipas studimit të bonitetit;<br><br>2. Gjithashtu, informojmë se në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Rural nuk ka patur kërkesë nga Këshilli Bashkiak për ndryshimin e statusit të tokës bujqësore ku do të ndërtohet. termocentrali me gaz në bashkinë Roskovec. | | |
| 28. | 15.10.2024 | A keni patur ndonje kerkese nga Agjencia Kombetare e Planifikim Territorit per ndryshimin e onitetit te tokes bujqesore ku do te ndertohet termocentrali me gaz ne Roskovec, nga toke bujqesore ne toke truall? Nese po, lutem na vini ne sipozicion keto kerkesa. | 28.10.2024 | Agjencia Kombetare e Planifikimit te Territorit me shkresën me Nr. 43, datë 10.1.2024 "Përcillet për mendim propozimi i Bashkisë Roskovec për Rrishikim të Dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV)" i është drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, lidhur me propozimin e Bashkisë Roskovec për ndërtimin e një Termocentrali (TEC) në territorin e Bashkisë Roskovec, në territorin e njësisë strukturore, R_B_B2_19/8, me përdorim aktual B_Tokë bujqësore, (kërkesën e gjeni bashkëlidhur në attach).<br>Kerkesa e AKPT.pdf<br>pergjigje per Roskovec.pdf | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 29. | 14.10.2024 | 1. Cilat janë masat konkrete për të garantuar zbatimin masiv të vaksinimit kundër brucelozës për të imtat, siç parashikohet në strategjinë për vitin 2024, dhe sa përqind e këtij vaksinimi është realizuar deri tani? Po ashtu, sa doza të vaksinës janë administruar deri në këtë moment?<br>2. Cilat janë masat konkrete që po ndërmerren për të siguruar efektivitetin e vaksinimit masiv të të imtave kundër brucelozës dhe si do të monitorohet përhapja e sëmundjes pas vaksinimit?<br>3. Çfarë plani ka Ministria për të përmirësuar raportimin dhe transparencën lidhur me numrin e krerëve të gjedhit të therur për shkak të brucelozës dhe | 23.10.2024 | 1. Të gjitha fermat dhe kafshët janë të identifikuara dhe të regjistruara në sistemin RUDA, për të siguruar që çdo fermer që mbarështon kafshë të jëtë i përfshirë në procesin e vaksinimit. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), si institucioni përgjegjës për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe zbatimin e masave profilaktike, zbaton protokollet strikte të vaksinimit për të siguruar cilësinë e vaksinimit, si dhe për të garantuar që të gjithë fermerët ndjekin udhëzimet e përcaktuara.<br>Gjithashtu ndër vite janë kryer fushata të gjëra ndërgjegjësimi dhe edukimi për | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | tuberkulozit, dhe si sigurohet që statistikat e raportuara të jenë të sakta? | | fermerët, në mënyrë që të kuptojnë rëndësinë e vaksinimit dhe të ndjekin me përpikëri procesin.<br>Veterinerët zyrtarë përgjegjës për vaksinimin janë të trajnuar për të zbatuar me efikasitet dhe profesionalizëm procedurat e vaksinimit, duke përfshirë ruajtjen e zinxhirit ftohës dhe administrimin korrekt të vaksinave si dhe do të kryhen kontrolle të rregullta në terren për të siguruar që vaksinimi do zbatohet në mënyrë të saktë që kafshët të jënë të mbrojtura.<br>Informojmë që vaksina REV-1 është në dispozicion për fillimin e vaksinimit. Vaksina e përdorur dhe e siguruar ka imunitet përgjatë gjithë jetës së kafshës. Vaksinimi do të kryhet bazuar në programin e kontrollit të miratuar dhe statusit fiziologjik të kafshëve. Ju bëjmë me dije që vaksinimi i brucelozës në të imta në Shqipëri ka filluar në vitin 2012. Duke marrë parasysh që vaksina jep imunitet për një periudhë 4-5 vjecare, janë të imunizuara përafërsisht 80% e krerëve në Republikën e Shqipërisë.<br>2. Qëllimi i vaksinimit është krijimi i statusit imunitar në tufat e të imtave. Për monitorimin e efikasitetit të vaksinës dhe imunitetit të krijuar do të kryhen testime serologjike sipas protokolleve të miratuara.<br>3. Programet e kontrollit dhe c’rrënjosjes së Brucelozës dhe Tuberkulozit në gjedh, zbatohen nga Drejtoritë Veterinare të AKVMB-së, të cilat raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të AKVMB-së dhe monitorohen nga kjo drejtori. Gjithashtu AKVMB dhe Ministria | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | njoftohet nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, nëpërmjet njoftim alert dhe hedhjes së rasteve positive në kohë reale në sistemin e menaxhimit të informacionit të laboratorit (LIMS). Sistemi LIMS është i ndërlidhur me sistemin RUDA, duke pasur një transparencë të rasteve positive. | | |
| 30. | 21.10.2024 | Kërkoj vendosjen në dispozicion të relacioneve përfundimtare të VKM-ve të mëposhtme, të miratuara me propozim të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:<br>“Për disa ndryshime në vendimin nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, të ndryshuar”<br>“Për kriteret për përdorimin e tokës bujqësore, për kryerjen e aktivitetit agrifotovoltaik dhe eolik në tokat bujqësore, procedurat për monitorimin e ushtrimit të aktivitetit, përfshirë masat për shkelje të kushteve të ushtrimit të aktivitetit dhepërcaktimin e tarifës”<br>“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për marrjen e masave parandaluese, për përhapjen e zjarreve në toka bujqësore”<br>“Për një ndryshim në vendimin nr. 226, datë 9.4.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi "Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes""<br>“Për disa shtesa në vendimin nr. 130, datë | | Signed_Relacionipermiratim2.pdf<br>Signed_a21Relacionriper miratim 114.6<br>Signed_2RelacionVKM13shtatorskemat<br>Signed_Relacionishoqeruespermiratim3<br>Signed_2Relacioni.pdf | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2024"" | | | | |
| 31. | 28.10.2024 | 1. Sa ton vaji ulliri u prodhuan në vitin 2023?<br>2. Sa është sasia e vajit të eksportuar për vitet 2021, 2022 dhe 2023?<br>3. Sivjet fermerët dhe fabrikat përpunuese ankohen për rënie të rendimentit të prodhimit, ndonëse sasia e prodhuar mbetet më e lartë se 2023, që ka ndikuar te kosto e lartë e prodhimit, së bashku me rritjen e pagesave të vjelësve dhe rënie rendimenti etj. Çfarë masash janë duke u ndërmarrë apo janë ndërmarrë nga Ministria e Bujqësisë për të ndihmuar fermerët në lehtësimin e kostos prodhuese?<br>4. A pritet të ketë rishikim të politikave fiskale, në drejtim të uljes së kostos së përpunueseve, konkretisht te skema e TVSH-së së rimbursueshme, pas heqjes së cilës kostot e prodhimit u rritën?<br>5. Çfarë po bëhet për shtimin e kapaciteteve grumbulluese, depozituese, paketuese dhe etiketimin te vaji i ullirit në marka të certifikuara? | 13.11.2024 | 1. Sasia e vajit te prodhuar per vitin 2023 sipas vrojtimit te subjekteve te medha te agroperpunimit eshte rreth **28 000 ton**<br>2.<br>• Sasia e eksportuar 2021 eshte **149 ton**;<br>• Sasia e eksportuar 2022 eshte **330 ton**;<br>• Sasia e eksportuar 2023 eshte **6,170 ton**.<br>3. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka mbështetur fermerët përmes Skemës Kombëtare të Mbështetjes nga buxheti i shtetit me një paketë masash që synon kryesisht uljen e kostove të prodhimit dhe rritjen e të ardhurave për fermerët. Konkretisht, fermerët që kultivojnë kulturën e ullirit janë mbështetur me naftë për punimet e mekanizuara në bujqësi nëpërmjet Skemës Kombëtare, duke ndihmuar fermerët në uljen e kostos së tyre të prodhimit. Sipas të dhënave nga AZHBR, në vitin 2023 kanë përfituar në total 53,154 fermerë nga masa mbështetëse e naftës, nga të cilat rreth 36% e tyre ishin aplikime me ullishte përfituese (specifikisht 19,222 aplikime), me numër parcelash prej | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 35,808, ose 16,505 hektarë sipërfaqe me ullishte.<br>- Nga të dhënat paraprake të vitit 2024, kemi një rritje të fermerëve aplikues me ullishte tek masa e naftës me një numër prej 19,492 aplikimesh, me 43,870 numër parcelash dhe një sipërfaqe prej 20,208 hektarësh me ullishte.<br>Me qëllim rritjen e kapaciteteve të prodhimit në ferma, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural përfshiu në paketën e masave mbështetëse për vitin 2024 edhe disa investimeve prioritare dhe me impakt tek fermerët, si: Mbështetje të investimeve për ndërtimin e serrave dhe stallave, për rrjeta anti-breshër, mekanikë bujqësore dhe akuakulturë.<br>Mbështetja për mekanizimin në sektorin e bujqësisë është pjesë e paketës së investimeve, duke qenë domosdoshmëri për rritjen e rendimentit të punës dhe uljen e kostove të prodhimit.<br>Fermerët që kultivojnë kulturën e ullirit, duke aplikuar në Skemën e Investimeve për masën mbështetëse “Për blerjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale” përfitojnë grant deri në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5,000,000 lekë për subjekt.<br>Përfituesve të financimit nga masat e | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mbështetjes së investimeve u paguhet paraprakisht deri në 30% të masës së financimit të kontraktuar, kundrejt garancisë së lëshuar nga shoqëri sigurimi dhe/ose banka.<br>Në aplikimet e bëra në këtë skemë grandesh që sapo përfundoi në datën 8 nentor, rreth 75% e aplikimeve ishin për mekanikë bujqësore, përfshirë edhe ullirin.<br>4. Politikat fiskale propozohen dhe hartohen nga Ministria e Financave, megjithatë MBZHR do të jetë pjesë aktive e këtij procesi.<br>5. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, në zbatim të ligjit Nr. 9947 datë 7.7.2008 "Për pronësisë industriale", i rishikuar, ligjit Nr. 8/2019 datë 26.2.20219 "Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore", ka asistuar Federatën Bujqësore Elbasan, për plotësimin dhe dorëzimin e aplikimit për emërtimin me tregues gjeografik për vajin e ullirit të Valmit, Elbasan. Ky aplikim pasi është vlerësuar pozitivisht është rregjistruar me emërtimin Tregues Gjeografik i Mbrojtur "Vaj ulliri Valmi, Elbasan". Po punohet dhe me grupe të tjerë prodhuesish për të mundësuar rregjistrimin nën skemat e cilësisë kryesisht me varietetet autoktonë të ullirit për vajin e ullirit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Po ashtu, përmes projektit të financuar nga Banka Botërore “Qëndrueshmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë”, në një nga komponentët, po punohet për shtimin e kapaciteteve të marketingut të ullirit dhe vajit të ullirit, ngritjen dhe mbështetjen e një organizate prodhuesish/konsorciumi të vajit të ullirit që synon forcimin e zinxhirit të vlerës së ullirit, si dhe ndërtimin e një qendre/stabilimenti tek një nga bashkitë e qarkut Berat, ku do te sigurohet ruajtja e vajit të ullirit, ambalazhimi dhe paketimi si dhe brandimi i vajit të ullirit.<br>Kjo përvojë, në vijimësi do të replikohet edhe në zona të tjera të vendit | | |
| 32. | 19.12.2024 | Gjatë kërkimit në fletoren Zyrtare QBZ (Qendra e Botimeve Zyrtare), nuk janë të publikuara 2 vendime të Këshillit të Ministrave:<br>Vendimi 296 1992<br>Vendimi 116 1994<br>Këto 2 vendime të mësipërme janë vendime pasuese për ndryshimin e vendimit nr.255 datë.02.08.1991 PËR KRITERET E NDARJES SË TOKËS BUJÇËSORE.<br>Kërkoj të pajisem në rrugë elektronike me vendimet e mëposhtme: Vendimi **296** viti **1992** , Vendimi **116** viti **1994** | 6.1.2025 | Vkm 255. 296. 116.pdf | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |
| 33. | 16.12.2024 | - Sa projekte zhvillimore ka ndërmarrë Ministria e Bujqësisë në kuadër të programt “100 fshatrat”? Sa është vlera e investimit? Ju lutem na vini në dispozicion | 8.1.2025 | kthim pergjigje.docx | Përgjigja i është dhënë e plotë. | 0 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | listën e projekteve që ka përfituar secili prej tyre dhe llojin e ndërhyrjes së përfituar...<br>- Deri kur parashikohet të zgjasë projekti 100 fshatrat? A keni një model zhvillimi për të ardhmen e këtyre fshatrave?<br>- A keni ndërtuar një mekanizmëm kontrolli se si kanë ndikuar këto investime në rigjallërimin e këtyre 100 fshtrave? | | | | |